



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:221808
Datë: 10.06.2024
Numri i dokumentit: 05801162

Ac.nr.10056/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Ylber Shurdhiqi dhe Adnan Konushevci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), sh.a. me seli në Prishtinë, kundër të paditurës F.P.S. nga Prishtina, Lagja “U.”, ... nr.17, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson N.H., avokat në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi-pasurim pabazë, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të së paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1758/2013 të datës 08.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të paditurës F.P.S. nga Prishtina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1758/2013 i datës 08.04.2021, në pikë I të dispozitivit, vërtetohet.

II. Mbeten të pashqyrtuara pika II dhe III e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1758/2013 i datës 08.04.2021.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.1758/2013 të datës 08.04.2021, në pikën një të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Korporata Energjetike e Kosovës-KEK, dhe ka detyruar të paditurën F.P.-S. nga Prishtina, që paditëses në emër të pasurimit pabazë, t’ia paguaj paditëses shumën prej 11,700 euro, me kamatë në lartësinë të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e afatizuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 19.07..2013 e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit ligjor. Në pikën dy, ka hudh poshtë kërkesëpadinë e paditëses Korporata Energjetike e Kosovës-KEK, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura F.P.-S. nga Prishtina, që paditëses në emër të pasurimit pa bazë, t’ia paguaj paditëses shumën prej 12.350 me kamatë ligjore prej 3.5% duke filluar nga data

25.02.2010 e deri në pagesën definitive. Në pikën tre, secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i të paditurës, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit, ta ndryshoj pikën një të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar duke e refuzuar kërkesëpadinë si të pabazuar apo ta prish pikën një të dispozitivit dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në vendosje të serishme.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar paditësja duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim që Gjykata e Apelit të refuzoj si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe aktgjykimin e atakuar C.nr.1758/13 të datës 08.04.2021, ta vërtetoj.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, me padinë e parashtruar në gjykatën e shkallës së parë, me datën 12.07.2013, ka kërkuar që të detyrohet e paditura për kompensimin e dëmit-pasurim pabazë, në shumën prej 25,270.30 euro. Në përgjigje në padi i autorizuari i të paditurës ka kontestuar kërkesëpadinë si të pabazuar.

Duke vepruar sipas padisë, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka vendosur për aprovimin e pjesëshëm të kërkesëpadisë, pas administrimit dhe shqyrtimit të provave: aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.826/08 i datës 12.05.2009m aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut, Ac.nr.673/09 i datës 30.10.2009 dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.96/10 të datës 18.04.2013. Gjykata e shkallës së parë, ka vendosur lidhur me lartësinë e kompensimit në emër të pasurimit pabazë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 212, 262 dhe 394 të LMD-së, lidhur me kamatën gjykata vendoi duke u bazuar në dispozitën e nenit 277 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform dispozitës së nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar sa i përket shumës prej 11,700.00 euro, pasi që duke u bazuar në dispozitën e nenit 210, paragrafi 4 të LMD-së (Ligji i RSFJ-së, i cili ligj ka

qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik), përcaktohet se: *“Detyrimi i kthimit, respektivisht i kompensimit të vlerës, fillon edhe kur diçka merret duke marrë parasysh bazën që nuk është realizuar ose që është hequr më vonë”*. Në rastin konkret, e paditura duhet që ti bëjë kompensimin paditëses për atë që është marrë pa bazë, meqë baza është hequr më vonë në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.96/2010 të datës 18.04.2013, në pikën tre të dispozitivit të këtij aktgjykimi është pranuar si i bazuar revizioni, janë ndryshuar aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë dhe është refuzuar kërkesëpadia e paditëses si e pabazuar sa i përket shumës prej 11,700.00 euro.

Sipas dispozitës së nenit 262, paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*, ndërsa me dispozitën e nenit 394 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kur detyrimi ka si objekt një shumë të hollash, debitori ka për detyrë të paguajë të njëjtin numër njësisish të hollash të, pagueshme nga detyrimi me përjashtim kur ligji urdhëron diçka tjetër”*. Duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk ka bërë kthimin e mjevete tek paditësja sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.96/2010 të datës 18.04.2013, e njëjta ka krijuar raport detyrimor me paditësen, e cila në rastin konkret ka cilësinë e kreditorit dhe mundësinë e kërimit të borxhit.

Lidhur me pretendimin ankimor të autorizuarit të paditurës se me Ligjin 04/L-077 të LMD-së, është përcaktuar se nuk mund të kërkohej kthimi i shumave të kompensuara në rast se pagesa i është bërë marrësit që ka vepruar me mirëbesim kurse me paragrafin 2 është përcaktuar si shumë e paguar pabazë llogaritet edhe pagesa mbi bazën e një vendimi gjyqësor që më vonë është ndryshuar apo prishur dhe se e paditura shumëat i kishte tërhequr duke vepruar me mirëbesim në bazë të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë dhe se njëjta nuk ka mundur që të dijë se një pjesë të shumës është duke e marrë pabazë ligjore. Gjykata e Apelit vlerëson se është pretendim i pabazuar, pasi që sipas dispozitave të LMD-së, nuk mund të kërkohej kthimi i shumave të kompensuara pa bazë në emër të shpërblimit të dëmit për shkak të lëndimit fizik, dëmtimit të shëndetit ose të vdekjes, në rast se pagesa i është bërë marrësit që ka vepruar në mirëbesim. Në rastin konkret e paditura nuk është kompensuar në bazë të lëndimit fizik, dëmtimit të shëndetit apo vdekjes në atë mënyrë që të mund të mbajë shumë e kompensuar nga paditësja. Po ashtu, gjykata ankimore vlerëson se në këtë rast nuk mund të zbatohen dispozitat e Ligjin 04/L-077 të LMD-së, pasi që i njëjti ligj ka hyrë në fuqi në Dhjetor 2012, dhe se në rastin konkret duhet zbatuar dispozitat ligjor të LMD-së, ligji i RSFJ-së, i cili ligj ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik.

Më tutje, gjykata e shkallës së dytë e ka vërtetuar edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me kamatën e gjykuar, pasi që e njëjta është në përputhje me dispozitën e nenit 277 të LMD-së.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palëve ndërgjyqës, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Gjykata e Apelit vendosi që të mbeten të pashqyrtuara pika II dhe III e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar pasi që pala ankuese nuk ka paraqitur ankesë sa i përket refuzimit të kërkesëpadisë si dhe shpenzimeve të procedurës.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.10056/2021, me datë 04.06.2024

Kryetare e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.